



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
UNIVERSITETI I TIRANËS
FAKULTETI I GJUHËVE TË HUAJA



PROJEKTI FITUES ME TITULL:

“RËNDËSIA E INTELIGJENCËS ARTIFICIALE NË FORMIMIN AKADEMIK”

**FINANCUAR NGA MINISTRIA E ARSIMIT DHE SPORTIT
NË KUADËR TË NDËRKOMBËTARIZIMIT
TË PROGRAMEVE TË STUDIMIT
PËR VITIN AKADEMIK 2022-2023**





EKIPI I PROJEKTIT:

Prof. Asoc. Dr. Eglantina GISHTI (koordinatore)

Prof. Asoc. Dr. Alba FRASHËRI

Dr. Fjoralba DADO

PERIUDHA E ZBATIMIT TË PROJEKTIT:

Qershor 2022 – Dhjetor 2023

PËRSHKRIM I PROJEKTIT

Projekti "*Rëndësia e Inteligjencës Artificiale në formimin akademik*" u propozua në vazhden e bashkëpunimit me Universitetin Sorbonne Paris Nord (USPN), në fushën e Inteligjencës Artificiale, specifikisht në Trajtimin Automatik të Gjuhëve si nëndegë e saj. Ky projekt erdhi si përgjigje e thirrjes së Ministrisë së Arsimit dhe Sportit, për projekte të përbashkëta në kuadër të ndërkombëtarizimit të programeve të studimit.



Projekti synon përforcimin e bashkëpunimit në disa dimensione: bashkëpunimi në fushën e kërkimit shkencor, shkëmbimi i njohurive dhe përmirësimi i tyre si dhe përvetësimi i kompetencave të reja lidhur me fushën e Inteligjencës Artificiale.

Nëpërmjet këtij projekti synohet gjithashtu, zhvillimi i kapaciteteve të infrastrukturës akademike, didaktike dhe kërkimore: pajisje hard dhe software për Trajtimin Automatik të Gjuhëve për qëllime specifike, krijimin dhe modelimin e databazave njëgjuhëshe dhe shumëgjuhëshe, të rëndësishme për përkthimin, kryesisht për procesin e përkthimit në kuadër të integritit të Shqipërisë në BE, etj.

Ngritja e infrastrukturës kërkimore-shkencore

Për realizimin sa më mirë të procesit të mësimdhënies dhe të kërkimit, u gjykua e nevojshme krijimi i një Laboratori Kërkimor, i ngjashëm me atë në Universitetin Sorbonne Paris Nord me logjistikën e duhur hardware dhe software.



QËLLIMI

Qëllimi kryesor i projektit është zhvillimi i programit të studimit me diplomë të dyfishtë në nivelin Master, i vetmi në këtë fushë i cili është i konceptuar mbi katër elemente bazë:

1. Ndërdisciplinariteti (si nëndegë e Inteligjencës Artificiale, specifikisht Trajtimi Automatik i Gjuhëve kërkon kombinimin e shkencave kompjuterike dhe shkencave gjuhësore);
2. Kërkimi shkencor (programet e studimit master janë të atashuara në laboratorë kërkimorë me qëllim përfshirjen e studentëve në projekte kërkimore);
3. Baza të forta në njohuritë teorike në fushën përkatëse;
4. Praktika e zhvilluar në institucione dhe kompani ndërkombëtare (sipas marrëveshjes midis dy institucioneve: Universiteti Sorbonne Paris Nord dhe Universiteti i Tiranës).



OBJEKTIVAT

- Qasja e integruar e projektit bazohet ne optikën e zhvillimit të qëndrueshëm, i cili mundëson njohjen e shpejtë të diplomave, rrjetin socio-ekonomik duke favorizuar teknologjitë e reja, me impakt të sigurt në zhvillimin e vendit dhe në integrimin rajonal ndërkombëtar.
- Forcimi i mësimdhënies në gjuhë të huaj si gjuhë në formimin e specializuar.
- Forcimi i bashkëpunimit brenda UT-së duke krijuar dhe zhvilluar studime ndërdisiplinare.
- Përfitimi nga politikat e mësimdhënies dhe kërkimin shkencor në vendet partnere;
- Mbështetja e Universitetit të Tiranës për thithjen e studentëve dhe fondeve të BE-së.

